

Nr.2046 i Regj. Themeltar
Nr.668 i Vendimit

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryesues
Artan Hoxha	Anetar
Evjani Sinoimeri	Anetare
Shpresa Beçaj	Anetare
Fatos Lulo	Anetar

ne seancen gjyqesore te dates 01.06.2006 mori ne shqyrtim ceshtjen civile qe u perket:

PADITËS: ARIAN NDOJA, perfaqesuar nga av.Vangjel Kosta
TË PADITUR: PRESIDENTI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE,
ne mungese
PROKURORIA E PERGJITHSHME E REPUBLIKES SE SHQIPERISE, ne
mungese

OBJEKTI I PADISË:

Anullim te Dekretit nr.4202,
date 13.04.2004 te Presidentit te Republikës.
Detyrimin e te paditurit Prokurorise se Pergjithshme
per pagimin e pages se nje viti.
Kushtetuta e Shqiperise, neni 42 i saj.
Ligji nr.8737, date 12.02.2001.
Nenet 153, 157, 324 te Kodit te Procedures Civile.

Gjykata e Apelit Tirane, me vendimin nr.11, date 11.02.2005 ka vendosur:

Rrezimin e kerkese padise.
Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.

Kunder vendimit te mesiperm ka ushtruar rekurs pala paditese duke parashtruar shkaqet e meposhtme:

- Paditesit i eshte njoftuar dhe jo komunikuar urdheri i Prokurorit te pergjithshem per fillimin e procedimit disiplinor ndaj tij. Nga administrimi i ketij urdheri gjate gjykimit rezultoi se ky urdher referon ceshtjen penale nr.1126 ne te cilen paditesi ka qene prokuror.
- Keshilli i Prokurorit megjithese ka degjuar paditesin, pa bere asnje verifikim te pretendimeve te tij, i ka komunikuar me goje paditesit konkluzionin se veprimet e tij perbejne "shkelje te disiplines" pa i komunikuar atij ndonje akt te ketij organi.
- Prokurori i Pergjithshem nuk i ka komunikuar paditesit nje akt te arsyetuar mbi propozimin derguar Presidentit te Republikes per largimin e paditesit nga detyra.
- Neni 28 i Ligjit "Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorise ne Republiken e Shqiperise" ka sanksionuar aktin ne te cilen iniciohet procedimi disiplinor si dhe organin perkates, Prokurorin e Pergjithshem. Ligji detyron kete akt te fillimit te procedimit disiplinor qe te pasoje ne menyre te detyrueshme te dhenat e nxjerra nga inspektimi te cilat i jane beret e njohura paraprakisht Prokurorit qe procedohet.
- Moskomunikimi i vendimit te keshillit te Prokurorise perfaqeson nje tjetër mosrespektim te frymes se ligjit lidhur me garancite e mbrojtjes se prokurorit gjate procedures disiplinore. Ky Keshill ne veshttrim te ligjit nuk perfaqeson organin ndeshkimor te procedurave, por nje hallke ndihmese ne teresine e mjeteve te garancise se nje procedimi te rregullt sipas parametrave kushtetuese. Per rrjedhoje prokurorit te proceduar nuk mund t'i hiqet mundesia per te shprehur opinionin e tij te lidhur me konkluzionet e ketij organi para organeve qe vazhdojne procedimin.
- Nuk mund te konsiderohet si "mosperputhje..." fakti qe nuk ka qene ne gjendje te mbroje profesionalisht akuzen per te mos u pranuar kerkesa "per ndryshimin e mases se sigurimit". Ne nje rast te tille nuk mund te flitet per mospermbushje te detyrave ne kuptimin e shkeljes disiplinore, pasi ky koncept i ligjit eshte shume me i gjere se rezultati i gjykimit lidhur me procedimet e prokurorit.

KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi degjoi relatimin e gjyqtarja Shpresa Beçaj,

Av.Vangjel Kosta, qe kerkoi ndryshimin e vendimit te Gjykates se Apelit Tirane dhe pranimin e padise, dhe pasi e bisedoi ceshtjen ne teresi,

V Ë R E N

Paditesi Arjan Ndoja ka kerkuar me padi gjyqesore anullimin e Dekretit te Presidentit te Republikes nr.4202, date 13.04.2004 per shkarkimin e tij nga detyra e prokurorit te rrethit gjyqesor Durres, me pretendimin se dekreti eshte i pabazuar ne ligjin nr.8737, date 12.02.2001 "*Per Organizimin dhe funksionimin e Prokurorise se Republikes se Shqiperise*".

Gjykata e Apelit Tirane e ka gjykuar ceshtjen si gjykate e shkalles se pare dhe me vendimin nr.11, date 11.02.2005 ka vendosur rrezimin e kerkesepadise duke arsyetuar se, "*.... ndaj paditesit jane zbatuar te gjitha normat ligjore qe kane te bejne me proceduren e marrjes se masave disiplinore dhe shkeljet e konstatuara nga paditesi me te drejte jane quajtur ne kundershtrim me permbushjen e rregullt te detyres*".

Kunder vendimit te Gjykates se Apelit Tirane ka bere rekurs ne Gjykatën e Larte paditesi, i cili ka percaktuar shkaqet e paraqitura ne pjesen hyrese te vendimit.

Kolegji Civil i Gjykates se Larte si shqyrtoi aktet e ndodhura ne dosje, shkaqet e parashtruara ne rekurs, si degjoi pretendimet e perfaqesuesit ligjor te paditesit, konstaton se rekursi i paraqitur nga paditesi permban shkaqe nga ato te parashikuara nga neni 472 i K.Pr.Civile.

Kolegji Civil i Gjykates se Larte arrin ne perfundimin e mesiperme pasi, nga aktet e administruara ne dosje rezulton se per procedimin disiplinor te paditesit nuk eshte zbatuar kerkesa e nenit 28 e ligjit nr.8737, date 12.02.2001 "*Per organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republiken e Shqiperise*", e cila parashikon se, "... *Procedimi mbeshetet ne te dhenat e nxjerra nga inspektimi, per te cilen prokurori qe procedohet eshte njoftuar paraprakisht*". Ne rastin konkret urdheri i Prokurorit te Pergjithshem "*Per fillimin e procedimit disiplinor te paditesit*", permban vetem ceshtjen penale me nr.1126, ndersa per ceshtjen tjeter me nr.1187, date 01.12.2003, nuk rezulton qe paditesi te jete njoftuar apo t'i jete komunikuar dokumentacioni i procedimit i nisur ne ngarkim te tij sikurse parashikon neni 29 i ligjit nr.8737, date 12.02.2001.

Gjithashtu nga te dhenat e akteve te ndodhura ne dosje nuk rezulton qe Keshilli i Prokurorisë ne baze te nenit 30 te ligjit te siperpermendur te kete verifikuar pretendimet e ngritura nga paditesi.

Duke qene se pretendimet e paditesit ne rekurs jane te drejta dhe te bazuara ne ligjin nr.8737, date 12.02.2001, Kolegji Civil cmon se eshte gabuar nga ana e punonjesve te Prokurorisë se Pergjithshme (*por jo Prokurori i Pergjithshem*) qe kane shtuar ne ceshtjet e diskutuara si shkelje edhe nje rast tjeter per te cilin nuk kishin asnje inspektim te komunikuar me pare paditesit, dhe as urdher te Prokurorit te Pergjithshem per te perfshire edhe kete rast ne procedimin disiplinor. Ne keto rrethana Kolegji Civil i Gjykates se Larte konstaton se paditesit nuk i eshte respektuar e drejta per t'u degjuar dhe mbrojtur ne lidhje me ceshtjen nr.1187, si elemente baze qe garantojne te drejten kushtetuese te cilitdo per nje proces te rregullt ligjor e per pasoje, kjo ceshtje duhet te perjashtohet nga ceshtjet e pretenduara me shkelje.

Lidhur me largimin e paditesit nga detyra e Prokurorit, ne Dekretin e Presidentit te Republikës eshte percaktuar vetem referenca ligjore, neni 32 "b" i ligjit nr.8737, date 12.02.2001. Nga materialet e ndodhura ne dosje del se paditesi eshte larguar me motivacionin "*Mospërmbushje e detyrave*". Duke ju referuar akteve ne dosjen gjyqesore nuk del se cila eshte shkelja e dukshme e kryer nga paditesi qe perben "*Mospërmbushje detyre*" ne ceshtjen penale nr.1126.

Ne kete ceshtje paditesi ka qene prokuror ne gjykimin "*per caktimin e masave te sigurimit*" dhe ka zbatuar dispozitat e K.Pr.Penale qe kane te bejne me, "*kriteret e vecanta per caktimin e mases se arrestit ne burg*". Ne baze te kesaj dispozite, "*arresti ne burg mund te vendoset vetem kur cdo mase tjeter eshte e papershtateshme per shkak te rrezikshmerise se vecante te vepres dhe te pandehurit*". Sipas nenit 25 pika 3 te K.Pr.Penale, prokurori i seances gjyqesore eshte i pavarur ne gjykimin e kerkimin e tij sipas vleresimit qe ai u ben fakteve dhe perputhjes se tyre me kerkesat e ligjit.

Referuar akteve te ndodhura ne dosje rezulton se ceshtja penale ne ngarkim te gjykuarit Edmond Xhaferi dhe te gjykuarve te tjere ka perfunduar me deklarimin e tyre fajtor e denimin e tyre me gjobe. Ne kete veshtrim masa e sigurimit “*arrest ne burg*” nuk eshte ne proporcion me kete denim, e nuk rezulton te kete sjelle pasoja te renda as per ceshtjen dhe as pasoja te tjera jashte saj.

Nga ana tjetere, Kolegji Civil cmon se nje prokuror ne keto kushte nuk mund te largohet nga detyra pasi, sipas nenit 27 te ligjit “*Per Prokurorine*” nuk eshte ne asnje nga rastet qe mund te perligje nje mase te rende te kesaj natyre. Sipas kesaj dispozite prokurori shkarkohet nga detyra, “*a) kur denohet me vendim gjykate te formes se prere, b) kryerja e veprimeve qe diskretitojne rende figuren e prokurorit, c) kur eshte vleresuar i paafte ne perputhje me pikat 4 e 3 te nenit 42 te ketij ligji*”.

Ne rrethanat e arsyetuara me siper Kolegji Civil i Gjykates se Larte cmon ndryshimin e vendimit te Gjykates se Apelit Tirane nr.11, date 11.02.2005 duke detyruar Prokurorine e Pergjithshme Tirane t’i paguaje paditesit pagen per 1 (nje) vit.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykates se Larte, ne baze te nenit 485/d te K.Pr.Civile,

V E N D O S I

Ndryshimin e vendimit nr.11, date 11.02.2005 te Gjykates se Apelit Tirane, duke detyruar Prokurorine e Pergjithshme t’i paguaje paditesit Arian Ndoja pagen per 1 (nje) vit.

Tirane, me 01.06.2006